



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:044150

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05352084

C.nr.369/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: M.N.1., M.N.2., dhe M.N.3., që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. N.M. nga Prizreni, kundër të paditurit F. (F) A. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.369/2021 e datës 09.03.2021, parashtruar nga paditësit: M.N.1., M.N.2., dhe M.N.3., që të gjithë nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit: M.N.1., M.N.2., dhe M.N.3., që të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarës të tyre, av. N.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurit F. (F) A. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, e autorizuara e palës paditëse, av. N.M. me parashtrësën C.nr.369/2021 të datës 15.02.2024, ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që paditësit dhe i padituri kanë arritur marrëveshje lidhur me objektin e kontestit.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësve, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që “paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”. Pastaj, me nenin 261 par. 3 të LPK-së përcaktohet se “po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:044150  
Datë: 21.02.2024  
Numri i dokumentit: 05352084

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.369/2021 të datës 21.02.2024

Gj y q t a r i

---

Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.